



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo



Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

**RREGULLORE PËR LICENCIMIN DHE RILICENCIMIN E PROFESIONISTËVE
TË OIK**

Prishtinë, 2024

KUVENDI I ODËS SË INFIERMIEREVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TJERË SHËNDETËSOR TË KOSOVËS (OIK-së) në mbështetje të Nenit 19, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.1 të Ligjit 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, Nenit 15, paragrafi 1 me nën-paragrafin 1.1 të Statutit të Odës së infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me _____, nxjerr këtë

R R E G U L L O R E P Ë R LICENCIMIN DHE RILICENCIMIN E PROFESIONISTËVE TË OIK

KAPITULLI I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra dhe kriteret e licencimit dhe rilicencimit të profesionistëve të OIK. Po ashtu përcaktohen kushtet e menaxhimit të regjistrave përkatës në të cilët mbahet evidenca e të gjithë profesionistëve të OIK që posedojnë licencën, përfshirë edhe ata të cilët rilicencohen.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Kjo rregullore zbatohet për procedurat e licencimit dhe rilicencimit të profesionistëve të OIK.
2. Kjo rregullore përfshinë dispozita edhe për çështje të tjera që ndërlidhen me procesin e licencimit dhe rilicencimit të profesionistëve të OIK.
3. Kjo rregullore nuk zbatohet për licencimin dhe rilicencimin e profesionistëve të OIK me shtetësi të huaj.
4. Për profilet të cilat ushtrojnë në mënyrë të pavarur profesionin miratohet rregullore e veçantë.

Neni 3 Përkufizimet

1. Termet dhe akronimet të përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1 **Licencimi** – procedura për dhënien e lejes profesionistit shëndetësor që të merret me veprimtari shëndetësore në Kosovë dhe që është i autorizuar ta ushtrojë veprimtarinë shëndetësore në pajtim me ligjin e zbatueshëm në Kosovë,
 - 1.2 **Anëtarë** - nënkupton infermierët, mamitë dhe të gjitha profesionistët e tjerë shëndetësorë pjesë e OIK,
 - 1.3 **Faksimili** – nënkupton vulën unike të cilën i licencuari e përdorë me rastin e lëshimit të dokumenteve dhe raporteve në bashkëngjitje të nënshkrimit personal në profilet të cilat ushtrojnë në mënyrë të pavarur,
 - 1.4 **Regjistri** – nënkupton Regjistrat e anëtarëve të OIK, Regjistrat e Licencave, Regjistrat e Rilicencave si dhe Regjistrin e revokimit të licencave dhe rilicencave

- 1.5 **Oda** – nënkupton Odën e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve tjerë Shëndetësorë të Kosovës,
 - 1.6 **Komisionet për RLR-** Nënkupton Komisionet përkatëse të OIK për regjistrimin, licencimin dhe rilicencimin e profileve përkatëse në kuadër të OIK,
 - 1.7 **EVP** – nënkupton Edukimin e Vazhdueshëm Profesional; dhe
 - 1.8 **MSh** – nënkupton Ministrinë e Shëndetësisë.
2. Termet dhe fjalitë që nuk janë të përfshira në përkufizimet sipas kuptimeve të dhëna në paragrafin 1 të këtij neni, do të interpretohen sipas kuptimeve të përgjithshme gjuhësore dhe njohurive të përgjithshme shkencore dhe teknike.

Neni 4

Përbërja dhe funksionimi i Komisioneve për Licencimin dhe Rilicencimin e Profesionistëve të Odës

1. Komisionet për Licencim dhe Rilicencim janë organe të Odës, të cilat propozohen nga Këshilli Drejtues dhe zgjedhen nga Kuvendi i Odës nga radhët e anëtarëve të Odës.
2. Puna dhe procedurat e vendimmarrjes të komisioneve për Licencim dhe Rilicencim janë të rregulluara me Rregulloren e punës të organeve dhe komisioneve të Odës.
3. Mënyra e zgjedhjes, kriteret dhe procedura e zgjedhjes së anëtarëve të Komisioneve për licencimin dhe Rilicencimin e Profesionistëve të Odës rregullohet me akt të veçantë normativ përkitazi me zgjedhjet e brendshme të Odës.

KAPITULLI II – LICENCIMI / RILICENCIMI I PROFESIONISTËVE TË OIK

Neni 5

Licenca e punës

Licenca e punës është dokument publik që dëshmon kompetencën profesionale të profesionistëve të Odës për kryerjen e pavarur të veprimtarisë shëndetësore në kuadër të profileve të anëtarëve të Odës në Republikën e Kosovës.

Neni 6

Detyrimi për licencim/rilicencim

1. Licencimi respektivisht rilicencimi i profesionistëve të Odës është i detyrueshëm për të gjithë profesionistët për ushtrimin e veprimtarisë shëndetësore nga profili përkatës sipas autorizimeve ligjore.
2. Licencimi / Rilicencimi është procedurë e veçantë administrative që ka karakter zyrtar dhe publik.
3. Regjistri i licencave mirëmbahet shërbimi profesional i Odës. Regjistrat përmbajnë së paku të dhënat si:

- 3.1 Emrin dhe Mbiemri e anëtarit;
 - 3.2 Numrin e Licencës;
 - 3.3 Profilin shëndetësor të anëtarit;
 - 3.4 Datën e lëshimit të Licencës;
 - 3.5 Datën e skadimit të Licencës.
4. Regjistri i revokimit të Licencave mirëmbahet nga Komisionet për Licencim, ndërsa regjistri i Rilicencave nga Komisionet për Rilicencim dhe përmbajnë së paku këto të dhëna:
- 4.1 Emrin dhe Mbiemrin;
 - 4.2 Numrin e Licencës;
 - 4.3 Arsyen për të cilën revokohet licenca;
 - 4.4 Faktin se revokimi është i përkohshëm apo i përhershëm.

KAPITULLI III – PROCEDURA E LICENCIMIT

Neni 7

Inicimi i procedurës për licencim/rilicencim

1. Procedura për licencim dhe rilicencim, iniciohet nga anëtari i Odës ose personi i autorizuar i tij me parashtrimin e aplikacionit për licencim/rilicencim.
2. Anëtarët e odës apo personi i autorizuar nga ai, mund të iniciojnë procedurën për rilicencim 90 (nëntëdhjetë) ditë para skadimit të afatit të licencës aktuale të punës dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë para skadimit të licencimit;
 - 2.1. Për anëtarët të cilët, veprojnë komfor afatit të përcaktuar për aplikim, Licenca paraprake vazhdon të jetë e vlefshme deri në nxjerrjen e vendimin për përmbushjen e kriterëve sipas aplikimit për rilicencim;
 - 2.2. Anëtarët të cilët nuk kanë respektuar afatin e paraparë në paragrafin 2, nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre deri në nxjerrjen e vendimin për përmbushjen e kriterëve sipas aplikimit për rilicencim.
3. Shërbimi profesional i Odës me rastin e pranimit të aplikacionit, parashtruesit i lëshon një vërtetim/konfirmim me të cilin dëshmohet dorëzimi i aplikacionit për licencim, respektivisht për rilicencim.
4. Aplikuesit të cilët e kanë respektuar afatin si në paragrafin e 2 të këtij neni, për të cilin OIK brenda afatit nuk ka mundur ta shqyrtoj aplikim, vërtetimin mbi mundësinë e ushtrimit të profesionit edhe pas skadimit të licencës mund ta marrin në administratën e OIK.
5. Mënyra e vlerësimit të pikëve kredituese lidhur me EVP-në, janë nën përgjegjësinë e Komisioneve përkatëse të profileve për Rilicencim të OIK, dhe çështjet përkitazi me këtë procedurë si dhe kriteret e valorizimit rregullohen me rregulloren për EVP.
6. Për çdo mëdyshje rreth procedurës së valorizimit, Komisionet mund të kërkojnë opinionin e KEVP-së

Neni 8

Kushtet për licencim/rilicencim të anëtarëve të OIK

1. Anëtarët e OIK, në vartësi të profileve mund të licencohen si profesionistë shëndetësor apo bashkëpunëtorë profesional, duke plotësuar këto kushte:
 - 1.1 Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;

- 1.2 Të jetë i diplomuar në lëminë e profileve të OIK në ndonjërin nga institucionet e akredituara të arsimit të lartë apo të ketë të nostrifikuar programin universitar sipas legjislacionit në fuqi ose të ketë të kryer shkollimin e mesëm nga profili përkatës;
- 1.3 Të ketë dhënë provimin profesional për ato profile në të cilat aplikohet/apo të ketë kryer stazhin profesional;
- 1.4 Të jetë i regjistruar dhe i anëtarësuar në Odë;
- 1.5 Të ketë paguar taksën e anëtarësisë dhe Licencimit në Odë.
2. Anëtarët e OIK për t'u rilicencuar duhet të plotësojnë këto kushte:
 - 2.1 Të ketë përmbushur kriterin e ndjekjes së EVP-së, të përcaktuar sipas rregullores për EVP apo të ketë dhënë provimin për vlerësimin e njohurive dhe shkathtësive profesionale;
 - 2.2 Të dorëzojë licencën paraprake kopje;
 - 2.3 Ti ketë përmbushur obligimet ndaj OIK;
 - 2.4 Të ketë realizuar pagesën për rilicencim;
 - 2.5 Kontratat apo dëshmitë tjera të cilat dëshmojnë për profilizimin përkatës sipas kriterëve të përcaktuara me rregullore.
3. Anëtari i Odës i cili ka arritur moshën 65 vjeçare, në momentin e aplikimit duhet të sjell certifikatën mjekësore për punë se është i aftë për ushtrimin e profesionit.
 - 3.1 Kohëzgjatja e licencës së punës nga paragrafi paraprak është 2 vite.
 - 3.2 Kriteret e EVP-së përcaktohet përshtatshëmrisht me kohëzgjatjen e licencës nga paragrafi paraprak.
 - 3.3 Taksa administrative për lëshimin e licencës për profilet nga paragrafi paraprak, paguhet në përpjesëtim me kohëzgjatjen e licencës së punës.

Neni 9

Rilicencimi i anëtarëve të cilët nuk përmbush kriteret e EVP për rilicencim

1. Anëtarët të cilët nuk ka plotësuar kriteret e parapara për EVP, respektivisht nuk ka grumbulluar pikët e nevojshme përmes aktiviteteve të EVP-së, obligohet t'i nënshtrohet Provimit për rilicencim, për vlerësimin e njohurive/shkathtësive për lëminë e caktuar, varësisht prej thirrjes profesionale të anëtarit.
2. Kandidati për provim të rilicencimit duhet të dorëzojë kërkesën dhe taksën administrative.
3. Provimi për rilicencim organizohet nga Komisionet për vlerësimin e njohurive/shkathtësive (KVNJ).
4. KVNJ formohet nga Këshilli Drejtues i OIK në vartësi nga profilet përkatëse të Odës. Shërbimi profesional i Odës është përgjegjës për mbarëvajtjen e procedurës dhe organizimit e provimit për rilicencim në vartësi nga profili shëndetësor i anëtarit të Odës.
5. Anëtarët të cilit kanë licencë të skaduar për periudhën nga 6 muaj deri në 5 vite, i nënshtrohen provimit për rilicencim nga komisioni.
6. Anëtari i cili ka licencë të skaduar për periudhën prej 5 vite deri në 10 vite, obligohet të kryejë stazhin praktikë nga profili përkatës në kohëzgjatje deri në 3 muaj.
7. Anëtari i cili ka licencë të skaduar për periudhën prej më shumë se 10 vite, obligohet të kryejë stazhin praktikë nga profili përkatës në kohëzgjatje deri në 6 muaj.

8. Periudha e mbajtjes së stazhit përcaktohet proporcionalisht me kohën e vonesës në rilicencim, përkatësisht për çdo 20 ditë vonesë mbi afatet e përcaktuara në paragrafi 6 dhe 7 mbahet një ditë stazhi profesional.
9. Programi stazhit hartohet nga komisioni profesional i emëruar nga Këshilli Drejtues dhe miratohet nga KD.
10. Pas përfundimit të stazhit nga pika 8, kandidati i nënshtrohet verifikimit të aftësive dhe shkathësive praktike të fituara gjatë stazhit profesional.
11. Vlerësimi i dijes do të bëhet përmes testimit teorik dhe praktik. Pjesa teorike e verifikimit bëhet përmes testeve, dhe hartohet nga KVNJ. Testi i aftësive të një profesionisti me profil specifik, do të bëhet sipas llojit të profilit që kryhet. Testi i aftësive të një profesionisti të përgjithshëm do të bëhet nga aspekti i përgjithshëm i profesionit. Vlerësimi i suksesit: është: "kaluar" ose "nuk ka kaluar".
12. Kandidati që ka kaluar me sukses provimin vlerësues, i lëshohet certifikatë për përfundimin e suksesshëm të provimit, me çka përmbyllet procesi i rilicencimit dhe anëtari pajiset me licencë. Certifikata e provimit nënshkruhet nga Kryetari i Odës mbi bazën e procesverbalit të Komisionit.
13. Nëse kandidati nuk e kalon provimin e rilicencimit është i detyruar t'i nënshtrohet provimit të dytë brenda tre (3) muajve nga data e provimit të parë.
14. Nëse edhe pas herës së tretë (3 muaj pas mbajtjes së herës së dytë të provimit) kandidati nuk e kalon vlerësimin përfundimtar ose nuk arrin atë, atëherë anëtari i nënshtrohet sërish stazhit profesional në periudhë prej 1 viti
15. Taksa administrative për organizimin e provimit për rilicencim rregullohet me vendim të veçantë të miratuar nga Këshilli Drejtues i OIK.

Neni 10

Baras vlerësimi

1. OIK bën baras vlerësimin e programeve në aspektin përmbajtësor dhe kohor, në rast të mospërputhjes së thirrjeve profesionale me thirrjet e parapara me Ligj, duke licencuar në thirrjen më të përafërt që njeh ligji.
2. Çështjet procedurale rregullohen me akt të veçantë të Këshillit Drejtues.

Neni 11

Përmbajta e aplikacionit dhe dokumentet për dorëzim lidhur me licencimin dhe rilicencimin e anëtarëve të OIK

1. Aplikacioni për licencim dhe rilicencim të anëtarëve të OIK përmbajnë të paktën këto dhënat e mëposhtme:
 - 1.1 Emri i personit, Emri i prindit dhe mbiemri;
 - 1.2 Data dhe vendi i lindjes;
 - 1.3 Adresa e vendbanimit;
 - 1.4 Vendi dhe data e diplomimit;
 - 1.5 Numri personal i letërnjoftimit;
 - 1.6 Të dhënat mbi vendin e punës, respektivisht institucionin shëndetësor, nëse është në marrëdhënie të punës;
 - 1.7 Numri i telefonit;

- 1.8 Adresa e e-mail;
 - 1.9 Deklarata nën betim;
 - 1.10 Nënshkrimi, data e aplikimit.
2. Dokumentet që duhet dorëzuar me rastin e licencimit të anëtarëve të Odës janë të paktën:
 - 2.1 Formulari për aplikim,
 - 2.2 Kopja e noterizuar e diplomës universitare ose shkollimit të mesëm
 - 2.3 Në rast se aplikuesi ka përfunduar studimet jashtë vendit, duhet dorëzuar vendimin e organit kompetent për nostrifikimin e diplomave të huaja,
 - 2.4 Certifikata e provimit të licencës për profilet në të cilat aplikohet/ dëshmitë e ndjekjes së stazhit profesional;
 - 2.5 Kopja e letërnjoftimit,
 - 2.6 Ekstraktin e lindjes,
 - 2.7 Fletëpagesa për licencim,
 - 2.8 Të dhëna tjera të cilat mund të kërkohen me vendim të Këshillit Drejtues në vartësi nga profili i cili aplikon
 3. Dokumentet që duhet dorëzuar me rastin e ri-licencimit të anëtarit të OIK janë të paktën:
 - 3.1 Formulari për aplikim,
 - 3.2 Licenca kopje e të cilën e posedon aplikuesi,
 - 3.3 Certifikatat e EVP dhe dëshmitë tjera për ndjekjen e aktiviteteve të EVP-së
 - 3.4 Deklarata nën betim,
 - 3.5 Kopja e letërnjoftimit,
 - 3.6 Ekstraktin e lindjes,
 - 3.7 Fletëpagesa për rilicencim;
 - 3.8 Të dhëna tjera të cilat mund të kërkohen me vendim të Këshillit Drejtues në vartësi nga profili i cili aplikon.

Neni 12

Vendimmarrja dhe lëshimi i licencës/rilicencës së punës

1. Komisionet për Licencim / Rilicencim të profileve anëtarë të OIK do të shqyrtojnë dokumentacionin së bashku me aplikacionin për licencim dhe do të nxjerrë vendim për lëndën përkatëse në afat prej 45 (dyzetepesë) ditëve nga dita e dorëzimit të dokumenteve.
2. Me rastin e nxjerrjes së vendimit mbi licencim apo rilicencim, Komisioni mund që:
 - 2.1 Të aprovojë kërkesën për licencim apo rilicencim të aplikuesit me të cilën lëshon Licencën si rekomandim për Kryetarin e OIK për nënshkrimin e saj.
 - 2.2 Të refuzojë licencimin apo rilicencimin e aplikuesit për shkak të mosplotësimit të kushteve sipas kësaj rregulloreje.
3. Komisioni për licencim mund që gjatë shqyrtimit të kërkojë nga parashtruesi të bëjë plotësimin e dokumentacionit që kërkohet për licencim apo rilicencim, duke i dhënë afat parashtruesit që plotësimin e tillë ta bëjë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e njoftimit, nëse parashtruesi nuk i përgjigjet afatit për plotësimin e dokumentacionit konsiderohet që nuk ka aplikuar fare.
4. Në procedurën e licencimit, zbatohet përshtatshmërisht me rregullat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

5. Palët e pakënaqur ndaj vendimeve të Komisioneve për Licencim apo Rilicencim sipas paragrafit 2, me nën paragrafët 2.2 dhe 2.3 të këtij neni, mund të parashtrojë ankesë pranë Këshillit Drejtues të Odës në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e pranimi të vendimit.
6. Në bazë të procesverbalit/vendimit të Komisionit për licencim të konstatuar në procesverbal, Kryetari i Odës nënshkruan licencën e punës e cila i dorëzohet personalisht parashtruesit.
7. Me rastin e dorëzimit të licencës, dorëzimi i tillë do të evidentohet në regjistrin e pranim-dorëzimit të licencave.
8. OIK lirohet nga përgjegjësia e ruajtjes së licencave të cilat nuk tërhiqen nga anëtarët brenda periudhës 6 mujore nga dita e njoftimit për gatishmërinë e saj për tërheqje. Në rast humbje pas këtij afati, anëtarit mund të kërkojë vetëm dublikatin e licencës.

Neni 13

Afatshmëria e licencës së punës

1. Licenca e punës për anëtarët e OIK, lëshohet me afat prej 5 (pesë) viteve e nënshkruar nga Kryetari i Odës sipas rekomandimit të Komisionit përkatës në procesverbal.
2. Në rast të humbjes së statusit të anëtarit të Odës, anëtarit i pushon validiteti i Licencës së punës.
3. Organi përkatës i Odës mund të informojë organet përkatëse në MSH, Inspektoratin Shëndetësor dhe punëdhënësin për skadimin e vlefshmërisë së Licencës së punës të anëtarit.

Neni 14

Përgjegjësia e përdorimit të licencës së punës

1. Licenca e punës i lëshohet anëtarit, në vetëm 1 (një) ekzemplar origjinal, ndërsa një kopje mbetet në dosjen e tij.
2. Licenca e punës në asnjë mënyrë nuk mund të përdoret nga ndonjë person tjetër në mënyrë që të arsyetojë ushtrimin e veprimtarisë të profileve të OIK.
3. E drejta për të ushtruar veprimtarinë e profileve të OIK në bazë të Licencës së lëshuar të punës, nuk mund të bartet e as të autorizohet te personi tjetër.
4. I licencuari është përgjegjës për ruajtjen dhe përdorimin e Licencës së punës sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.
5. Në rast të humbjes së licencës apo të dëmtimit të saj i licencuari duhet ta publikojë në njëerën nga gazetatat ditore vendore apo ta paraqesë në polici. Fotokopjen e këtij publikimi duhet t'ia bashkëngjisë shkresës njoftuese për Odën.
6. Tërheqja e licencës bëhet nga anëtari personalisht, apo personit të autorizuar nga ana e palës.

Neni 15

Përmbajtja e dokumenti të licencës së punës

1. Autorizimi për punë të pavarur (licenca e punës) është dokument letre në format A4 dhe ka këtë përmbajtje:
 - 1.1 Në këndin e sipërm majtas të dokumentit gjendet stema e Republikës së Kosovës, ndërsa në këndin e sipërm djathtas gjendet e logo e Odës,
 - 1.2 Në pjesën e sipërme të dokumentit shënohet baza juridike e lëshimit të licencës së punës,
 - 1.3 Në mes të dokumentit është emri i dokumentit "Licencë e punës". Nën tekstin e përmendur janë të dhënat për emrin dhe mbiemrin, titullin profesional, data dhe vendi i lindjes, numri personal/letërnjoftimit të mbajtësit të dokumentit dhe qëllimin e lëshimit të dokumentit, me tekstin: "Për të ushtruar profesionin në mënyrë të pavarur në tërë territorin e Kosovës, meqë i plotëson kushtet e parapara me Ligj,"
 - 1.4 Në pjesën e poshtme të dokumentit janë të dhënat e mbajtësit të dokumentit varësisht nga statusi profesional: numri i diplomës së studimeve apo certifikatës së provimit, , numri identifikues i licencës (kodi), data e lëshimit dhe data e skadimit të licencës së punës,
 - 1.5 Në këndin e poshtëm majtas figuron QR CODI, ndërsa në këndin e poshtëm djathtas figuron nënshkrimi i kryetarit të OIK.
2. Dokumenti i licencës së punës shkruhet në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

Neni 16

Licenca e punës për dy apo më shumë PROFILE

1. Anëtarit i cili është i profilizuar në më shumë se një profil të ndryshëm për secilin prej tyre i lëshohet licencë e veçantë.
2. Licenca e punës për secilin profil kanë numër unik identifikues, dhe si të tillë janë dokumente të veçanta për të cilat poseduesi i tyre ka përgjegjësi për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre.

Neni 17

Kopja e dublikuar e Licencës së punës

1. Me kërkesë të anëtarit të Odës, shërbimi profesional i Odës mund të lëshojnë Licencë pune të dublikuar, në rast se origjinali është humbur apo dëmtuar rënd, pas shpalljes së pavlefshme në ndonjë gazetë ditore apo në polici, në të cilën do të shënohet se është dublikatë i Licencës së punës origjinale.
2. Shërbimi Profesional i Odës do të lëshojë licencën e punës dublikatë në afat të përputhshëm me afatin e Licencës së punës origjinale.
3. Parashtruesi i kërkesës për lëshimin e Licencës së punës dublikatë, është i obliguar që të paguajë taksën administrative për këtë shërbim në përputhje me tarifën administrative në fuqi.

Neni 18

Aplikimi me vonesë për licencim/rilicencim

1. Nëse anëtari i Odës nuk i nënshtrohet procesimit të licencimi brenda afatit prej 5 vit nga dhënja e provimit shtetërorë për licencim, i nënshtrohet vlerësimit të aftësive/shkathtësive profesionale nga Komisioni përkatës i odës dhe/ose mbajtjes së stazhit profesional.
2. Nëse anëtari i Odës nuk i nënshtrohet procesimit të licencimi brenda afatit prej 5 vite nga përfundimi i stazhit profesional, i nënshtrohet vlerësimit të aftësive/shkathtësive profesionale nga Komisioni përkatës i odës dhe/ose mbajtjes së stazhit profesional.
3. Nëse anëtari i Odës nuk i nënshtrohet procesimit të rilicencimi brenda afatit prej 6 muaj nga skadimi i licencës, i nënshtrohet vlerësimit të aftësive/shkathtësive profesionale nga Komisioni përkatës i odës dhe/ose mbajtjes së stazhit profesional.
4. Procedura e provimit, stazhit dhe vlerësimit të aftësive/shkathtësive profesionale rregullohet përshtatshëmrisht me anëtarët të cilët nuk kanë plotësuar kriteret për EVP.

KAPITULLI IV – FAKSIMILI SI SHENJË E IDENTIFIKIMIT PERSONAL DHE PROFESIONAL

Neni 19

Mënyra e lëshimit dhe përdorimit të faksimilit

1. Profilet të OIK të cilët ushtrojnë në mënyrë të pavarur profesionin pajisen me faksimil, i cili shërben si shenjë e identifikimit personal dhe profesional.
2. Anëtari i Odës nga profilet si në paragrafin e 1 të këtij neni, krahas kërkesës për faksimil duhet të dorëzoj: kopjen e licencës së punës
3. I licencuari i cili është posedues i dy apo më shumë licencave të punës me profile të veçanta për secilën profil i lëshohet faksimil i veçantë.
4. Faksimili përdoret gjatë ofrimit të drejtpërdrejtë të kujdesit shëndetësor, për vërtetimin e dokumentacionit mjekësor.
5. Një person tjetër nuk mund ta përdorë faksimilin në emër dhe për llogari të bartësit të faksimilit.

Neni 20

Përmbajtja e faksimilit

1. Faksimili ka këtë përmbajtje:
 - 1.1 Logo e Odës,
 - 1.2 Emrin dhe mbiemrin e të licencuarit,
 - 1.3 Thirrjen profesionale për të cilën është licencuar,
 - 1.4 Kodin e licencës së punës.
2. Madhësia dhe lloji i shkronjave në faksimil përcaktohen me vendim të Këshillit Drejtues të Odës.

Neni 21

Dorëzimi i faksimilit

1. Pronar i faksimilit është Oda, dhe si i tillë duhet t'i dorëzohet organit kompetent në të gjitha rastet përshtatshëm me dorëzimin e ID kartelës.
2. Të dhënat personale dhe të dhënat tjera relevante që evidentohen në Regjistrin e anëtarësisë së Odës, në Regjistrin e licencimit dhe rilicencimit, dokumentin e Licencës së punës dhe në faksimil, do të bazohen në dokumentin e lëshuar nga organi përkatës shëndetësor arsimor dhe nga organi i gjendjes civile, i cili nuk do të jetë më i vjetër se 6 (gjashtë) muaj, apo letërnjoftimi me afat valid.
3. Në rast të dëmtimit apo humbjes së faksimilit nga anëtari i Odës, i njëjti është i obliguar që në afat sa më të shkurtër kohor ta njoftojë Odën dhe sipas mundësisë ta dorëzojë kërkesën (formularin) për faksimilin e dytë, bashkë me publikimin e humbjes së faksimilit në ndonjërin nga gazetatat ditore.
4. Në rast mos përmbushjeve të detyrimeve nga ky nen, shërbimi profesional inicion procedurën pranë Këshillit Etik për mos përmbajtje të detyrimeve nga anëtari.

Neni 22

Zbatimi i masave disiplinore të shqiptuara nga organet e mbikëqyrjes etike dhe profesionale

1. Shërbimi Profesional i Odës është përgjegjës për ekzekutimin e masave disiplinore përkritazi me revokimin e përkohshëm apo të përhershëm të licencës dhe heqjes nga regjistri i anëtarësisë dhe regjistri i licencave.
2. Shërbimi Profesional i Odës do të bëjnë ekzekutimin e masës disiplinore sipas urdhrin të organit kompetent që ka shqiptuar masën disiplinore në përputhje me procedurat e parapara për organet etike të OIK.
3. Me rastin e ekzekutimit të masës disiplinore sipas vendimit të organit kompetent, Shërbimi Profesional i Odës do të njoftojnë Këshillin Etik për ekzekutimin e masës së tillë, në mënyrë që të bëhet evidentimi i ekzekutimit të masës disiplinore në regjistrin e veçantë për masat e shqiptuara disiplinore.

Neni 23

Taksat administrative

1. Taksa administrative për licencim dhe rilicencim caktohet me rregullore për caktimin e lartësisë së taksave administrative, e miratuar nga Kuvendi.
2. Taksa administrative për licencim dhe rilicencim caktohet për periudhën 5 vjeçare.

KAPITULLI V – DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 24 Hyrja në fuqi

1. Kërkesat për procedurat e Regjistrimit, licencimit dhe rilicencimit të anëtarëve të pranuar në Odë para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje do të zgjidhen në përputhje me rregulloren sipas së cilës është nisur procedura. Përjashtimisht dispozitat e kësaj rregullore zbatohen nëse janë më të favorshme për anëtarët.
2. Dispozitat e paragrafit 5, 6 të nenit 17 të kësaj rregullore zbatohen nga data 1 Janar 2025.
3. Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditën pas miratimit të saj nga Kuvendi i Odës.
4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen aktet tjera ligjore të Odës të cilat janë në kundërshtim me të.
5. Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje janë Shtojcat.
6. Çështjet nga fushë veprimtaria e zyrës administrative për Regjistrim, licencimin dhe rilicencimin e anëtarëve të OIK, të cilat nuk janë të përcaktuara me këtë rregullore, procedohen në KD, deri në plotësim-ndryshimin e saj.
7. Kjo rregullore publikohet në ueb faqen e Odës.

Prishtinë, 2024